



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 23, QARKU DURREËS, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 10.05.2019, me pjesëmarrjen e:

|         |           |                 |
|---------|-----------|-----------------|
| Klement | ZGURI -   | Kryetar         |
| Denar   | BIBA -    | Zëvendëskryetar |
| Bledar  | SKËNDERI- | Anëtar          |
| Edlira  | JORGAQI-  | Anëtare         |
| Rezarta | BITRI-    | Anëtare         |

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr. 23, Qarku Durrës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1 germa "a", neni 93 dhe 94 pika 1, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1564 prot., datë 20.03.2019, i është drejtuar Prefektit të Qarku Durrës, duke kërkuar paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut Durrës që përmbushin kriteret e neneve 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015. për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për gjashtë (6) Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Prefekti i Qarkut Durrës, me shkresën nr. 2489 prot, datë 23.04.2019, i ka paraqitur KQZ-së propozimet për ambiente të cilat mund të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave për seicilën nga VNV-të e Qarkut Durrës.

Ambienti i propozuar për krijimin e VNV-së për ZAZ-në Nr. 23, Qarku Durrës, është:



**Nr. 286 i Vendimit    Data 10.05.2019 e Vendimit    Ora 11.00 e vendimit**

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.23, Qarku Durrës,  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

1. Palestra e Shkollës profesionale "Hysen Çela", me sipërfaqe rreth 350 m<sup>2</sup>;

Ky ambient ka qenë Vend i Numërimit të Votave edhe në zgjedhjet e 2017, ndodhet brenda Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit",

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

### **V E N D O S I**

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 23, Qarku Durrës, në Palestra e Shkollës profesionale "Hysen Çela", Bashkia Durrës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

|                |                  |   |                        |
|----------------|------------------|---|------------------------|
| <b>Klement</b> | <b>ZGURI</b>     | - | <b>Kryetar</b>         |
| <b>Denar</b>   | <b>BIBA</b>      | - | <b>Zëvendëskryetar</b> |
| <b>Bledar</b>  | <b>SKËNDERAJ</b> | - | <b>Anëtar</b>          |
| <b>Edlira</b>  | <b>JORGAQI</b>   | - | <b>Anëtare</b>         |
| <b>Rezarta</b> | <b>BITRI</b>     | - | <b>Anëtare</b>         |



**Nr. 286 i Vendimit    Data 10.05.2019 e Vendimit    Ora 11.00 e vendimit**

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.23, Qarku Durrës,  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019